

VENDIM
Nr. 417, datë 15.6.2022

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE NR. 3038,
FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER,
QARKU I FIERIT, NGA SHOQËRIA “EZ-5 ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit, nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., me elementet e mëposhtme:

- a) emrin e aplikuesit: shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.;
- b) numrin e identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L91325503D;
- c) tipin e centralit: fotovoltaik;
- ç) kapacitetin e instaluar: 10 mw;
- d) afatin e pritshëm të vënies në punë: koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;
- dh) vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë: në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit;
- e) afatin e operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) koordinatat e tokës sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ose institucione të tjera të autorizuar kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;
- g) e drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- gj) shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuar informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;
 - ii. të respektojë kushtet e përmendura në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj. Shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit

fotovoltaik. Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. dhe shoqëria për qëllime të veçanta do të jenë bashkërisht përgjegjëse për detyrimet sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. duhet t’i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

ANEKSI 1

Sistemikoordinativ ALBANIA 1987- GK, ZONA 4			Sistemikoordinativ KRRGJSH		
Siperfaqja 1 Gaus-Kruger			Siperfaqja 1 KRRGJSH		
Nr	Veri x	Lindje y	Nr	Veri	Lindje
1	4509908.940	4366463.590	1	4508738.33	450836.08
2	4509807.438	4366353.281	2	4508636.13	450727.58
3	4509944.573	4366229.380	3	4508770.53	450600.18
4	4509952.871	4366216.432	4	4508778.23	450587.58
5	4509818.572	4366069.625	5	4508643.83	450443.38
6	4509957.540	4365945.602	6	4508780.33	450316.68
7	4510193.310	4366203.893	7	4509019.73	450574.28
Sip 1 =95,665m ²					
Siperfaqja 2 Gaus-Kruger			Siperfaqja 2 KRRGJSH		
Nr	Veri	Lindje	Nr	Veri	Lindje
1	4509634.395	4366460.405	1	4508462.95	450837.07
2	4509483.192	4366291.864	2	4508312.45	450669.07
3	4509615.423	4366159.783	3	4508440.55	450536.07
4	4509773.853	4366334.204	4	4508601.55	450707.57
Sip 2 =40,000m ²					
Sip Totale = 13.56 Ha					